



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË


Korçë, me 30.06.2023

SHPLLJE VENDIMI

Drejtur : Bashkise Maliq

Për: Aleko Zenullari

Me adrese: Fshati Vreshtas Bashkia Maliq



Bashkalidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr. 155 dt. 25.02.2022 për t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor*, pasi dëftesa e komunikimit është kthyer me shënimin : “ Larguar, ka ndryshuar adrese ...” dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Geralda Kasuli



U afishua sot ne datë -----

Per Bashkine Maliq

(emër, mbiemër, firmë)

Nr. 78 Prot

- M. A. Vreshtas
- S. T. I. M. P.
- 04.05.09.2023

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
KORCE

NR.REGJ.THEM.21001-01768-41-2021 (495/1394)
DT.REGJ.18.10.2021

NR.VENDIMI 41-2022-589 (155)
DT.VENDIMI 25.02.2022

V E N D I M
“ Ne emer te Republikes”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korce e perbere prej :

Gjyqtare : Eglantina Mikani

Asistuar nga sekretare e séances gjyqesore Vitoria Hajçe, sot ne dt.25.02.2022, ora 12.⁰⁷ mori ne shqyrtim ne seance pergatitore me dyer te hapura ceshtjen civile me nr.regj.them. 21001-01768-41-2021 (495/1394) date regjistrimi 18.10.2021 qe i perket:

Paditese : Mimoza Shytka, e bija e Muhamet dhe Sofije, e datelindjes 21.08.1965, lindur dhe banuese ne Korce, perfaqesuar me prokure te posacme me nr.3577 rep. e nr.2307 kol. dt.12.07.2021 nga Av.Ledian Spaho, e martuar, pa femije, ne mungese.

I paditur : Aleko Zenullari, i biri i Tajar dhe Besika, i datelindjes 15.11.1975, lindur dhe banues ne fshatin Vreshtas, Bashkia Maliq, i martuar pa femije, ne mungese njoftuar me shpallje.

Objekti : Zgjidhjen e marteses ligjore te lidhur midis paleve ne date 01.10.2013.

Baza ligjore: neni 132 i K.Familjes.

Gjykata, pasi konstatoi mungesen ne gjykim te paditeses dhe te te paditurit, pasi shqyrtoi aktet e bisedoi ne teresi ceshtjen

V E R E N

Me kerkese padi te depozituar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Korce ne dt.15.10.2021 paditesja Mimoza Shytka duke thirrur si te paditur bashkeshortin e saj Aleko Zenullari ka kerkuar : ” *Zgjidhjen e marteses ligjore midis paleve te lidhur ne date 01.10.2013*”, kerkim kete te cilin e ka bazuar ne nenin 132 te K.Familjes.

Ne seancen e dt.25.02.2022, te planifikuar nga gjykata per tu zhvilluar si séance pajtimore, paditesja Mimoza Shytka nuk eshte paraqitur ndonese kishte marre djeni rregullisht lidhur me zhvillimin e saj nepermjet perfaqesuesit te saj me prokure te posacme, Av.Ledian Spaho i cili ishte njoftuar rregullisht me leterthirrjen e dt.20.01.2022 persa ne kerkesepadi ishte pasqyruar si adrese kontakti adresa e ketij te fundit. Nderkohe qe nuk eshte bere present per gjykatën ndonje shkak i arsyeshem lidhur me kete

mosparaqitje. Nuk eshte paraqitur ne kete séance as i padituri Aleko Zenullari, i njoftuar rregullisht nepermjet afishimit te shpalljes publike, ne kushtet kur rezultoi se ndodhej jashte shtetit.

Ne te tilla rrethana, referuar nenit 179 paragrafi i pare i K.Pr.Civile sipas te cilit : “Nese paditesi ose asnje nga palet pa ndonje shkak te arsyeshem, nuk paraqiten ne séance perгатitore... dhe rezulton se kane djene rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit te ceshtjes”; nenit 299 po te K.Pr.Civile sipas te cilit : “ Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: ...ç) Pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht ne ligj.”; dhe se fundi percaktimin e nenit 135 te K.Familjes, ne te cilin ligjvenesi ka parashikuar shprehimisht pushimin e gjykimit te ceshtjes ne rast mosparaqitje personalisht te paditesit ne séance perгатitore dhe te zbatuara keto per rastin ne gjykim, cmon se jane kushtet ligjore te parashikuara prej tyre per pushimin e gjykimit te kesaj ceshtje civile.

Persa i perket shpenzimeve gjyqesore te evidentuara deri ne kete faze te gjykimit ato rezultojne te parapaguara nga pala paditese ku perfshihet tarifa mbi aktet dhe ajo per njoftimin e paleve. Referuar nenit 106 e vijues te K.Pr.Civile ne kushtet e pushimit te ceshtjes per shkak te mosparaqitjes te pales paditese, nga gjykata cmohet qe ato ti lihen ne ngarkim asaj, pra sic jane kryer.

Sa me siper provohet nepermjet dokumentave shkresore te ndodhura ne dosjen gjyqesore.

PER KETO ARSYE

Ne baze te nenit 127, 179/1, 299/ ç te K.Pr.Civile

V E N D O S I


Pushimin e gjykimit te ceshtjes civile me nr.regj.them. 21001-01768-41-2021 (495/1394) date regjistrimi 18.10.2021, me pale ndergjyqese : paditese Mimoza Shytka, i paditur Aleko Zenullari, me objekt: “Zgjidhja e marteses ligjore midis paleve te lidhur ne date 01.10.2013”.

Shpenzimet gjyqesore te parapaguara nga pala paditese lihen ne ngarkim te saj.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit te vendimit te arsyetuar në Gjykatën e Apelit Korce. Per palen e paditur ky afat fillon nga e nesermja e njoftimit te vendimit nepermjet afishimit te shpalljes publike.

U shpall ne Korçe sot ne dt.25.02.2022.

SEKRETARE
Vitoria HAJCE



GJYQTARE
Eglantina MIKANI

